



Prishtinë, 27 prill 2017
Kodi i ZRRE-së: V_916_2017

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5, paragrafi 3 dhe 4, Nenit 25, Nenit 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2, dhe Nenit 51 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 3 paragrafi 1 nënparagrafet 51 dhe 72, Nenit 5, Nenit 33 paragrafi 4 nënparagrafi 4.1, Nenit 37, Nenit 38 dhe Nenit 62 paragrafi 7 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085);
- Rregullën për Vendosjen e të Hyrave të Furnizuesit me Shërbim Universal;
- Dispozitat e Nenit 17 të Licencës për Furnizim me energji elektrike lëshuar ndërmarrjes "KOSOVO ELECTRICITY SUPPLY COMPANY" (KESC) J.S.C me numër licence ZRRE/Tr_2014/Li_07/17, e datës 27.04.2017;
- Vendimin e Bordit të Rregullatorit lidhur me kriteret e matjes së konkurrencës, të datës 30 mars 2011;
- Vlerësimin e Konkurrencës së tregut të energjisë përmes Indeksit të Herfindahl-Hirschman (HHI), të datës 29.12.2016;
- Dispozitat e Neni 3, paragrafi 2 të Udhëzuesit për Liberalizimin e Tregut të Energjisë Elektrike në Kosovë, i datës 17.01.2017;

në seancën e mbajtur më 27 prill 2017 nxori këtë:

V E N D I M

PËR VENDOSJEN E OBLIGIMIT TË SHËRBIMIT PUBLIK

- I. I Vendoset të Licencuarit për Furnizim me energji elektrike "KOSOVO ELECTRICITY SUPPLY COMPANY" (KESC) J.S.C (në tekstin në vijim "KESCO"), obligimi i shërbimit publik për furnizim të konsumatorëve fundorë që gëzojnë të drejtën e furnizimit universal.
- II. Të drejtën e furnizimit si shërbim universal e gëzojnë:
 - a. të gjithë konsumatorët familjar;
 - b. Konsumatorët jo-familjar që kanë qarkullim vjetor jo më shumë se dhjetë milion euro (10,000,000 €), ose jo më shumë se pesëdhjetë (50) punonjës;
 - c. Konsumatorët e kyçur në nivel të tensionit 110kV, 35kV dhe 10kV për një fazë tranzitore derisa të gjejnë furnizues në treg, mirëpo jo më vonë se 31 mars 2018, përveç konsumatorëve të cilët gëzojnë të drejtën e furnizimit nën kushtet e shërbimit universal.

- III. Konsumatorët e kyçur në nivelin e tensionit 0.4 kV do t'i nënshtrohen kushteve dhe çmimeve të tregut për furnizim me energji elektrike pas përpilimit të listës nga ana e ZRRE, e cila do të identifikoj konsumatorët të cilët nuk i plotësojnë kriteret e përcaktuara me ligj për furnizim me energji elektrike nga Shërbimi Universal.
- IV. Të gjithë konsumatorët fundor kanë të drejtë të furnizohen me energji elektrike në tregun konkurrues nga data 1 prill 2017.
- V. Rregullatori do ti rregullojë çmimet e energjisë elektrike të konsumatorëve që gëzojnë të drejtën e furnizimit në kuadër të shërbimit universal, të cilat mbulojnë kostot e arsyeshme të furnizimit me energji elektrike.
- VI. Niveli i kostove për furnizim me energji elektrike dhe i çmimeve do të rishikohen në baza vjetore, në pajtim me Rregullën për Vendosjen e të Hyrave të Furnizuesit me Shërbim Universal.
- VII. Furnizuesi i ngarkuar me obligimin e Shërbimit Publik, sipas këtij vendimi obligohet që të:
 - a. furnizojë me energji elektrike si shërbim publik sipas kushteve të përcaktuara me këtë Vendim, me licencë, si dhe me legjislacionin tjetër në fuqi;
 - b. informojë konsumatorët (blerësit) për të drejtat e tyre dhe kushtet e furnizimit në kuadër të shërbimit universal;
 - c. furnizojë me energji elektrike të një cilësie të caktuar sipas Rregullës për Standardet e Cilësisë së Furnizimit dhe Shërbimit;
 - d. faturojë energjinë elektrike të livruar në pajtim me çmimet e arsyeshme, të përcaktuara nga Rregullatori;
 - e. publikojë tarifën në faqen e vet të internetit, së paku pesëmbëdhjetë (15) ditë para fillimit të aplikimit.
- VIII. Obligimi i ngarkuar KESCO-s sipas këtij Vendimi caktohet për një periudhë prej tri (3) vitesh, dhe zbatohet nga data 01.04.2017 deri më datën 31.03.2020.
- IX. Ky Vendim do të jetë pjesë përbërëse e Licencës për Furnizim me energji elektrike të lëshuar "KESCO"-s.

ARSYETIM

1. Rregullatori me 29 dhjetor 2016 ka bërë Vlerësimin e konkurrencës në tregun e energjisë elektrike në Kosovë, përmes Indeksit Herfindahl-Hirschman (HHI) të pjesëmarrjes së furnizuesve në treg.
2. Rezultati nga Vlerësimi i konkurrencës, tregon se është koncentrim i madh i vetëm një furnizuesi në tregun me pakicë të energjisë elektrike në Kosovë.
3. Si pasojë e mungesës së konkurrencës efektive, me qëllim të sigurisë së furnizimit të qëndrueshëm, mbrojtjes së konsumatorëve dhe parandalimit të abuzimit me pozitën dominuese të furnizimit me energji elektrike, Rregullatori vendos Obligime të Shërbimit Publik për ofrimin e Shërbimit Universal me energji elektrike.
4. Obligimi i shërbimit publik i është vendosur KESCO-s, si në dispozitiv të këtij vendimi, duke u bazuar në aftësitë ekonomike dhe operative për ofrimin e furnizimit, koncentrimin më të

madh në tregun e energjisë me pakicë dhe mungesës së furnizuesve tjerë aktiv në tregun me energji elektrike.

5. Rregullatori ka licencuar tre furnizues për furnizim me pakicë të energjisë elektrike, dy prej të cilëve ende nuk janë aktiv në treg. Një nga pengesat e operimit të tyre në treg është edhe mosnjohja e Operatorit të Sistemit të Transmisionit/Operatorit të Tregut OST/OT të Kosovës si zonë rregulluese dhe anëtarësi në ENTSO-E.
 6. Në mungesë të konkurrencës në sektorin e energjisë elektrike me pakicë në Kosovë, edhe konsumatorët në nivelin e tensionit 110kV, 35kV dhe 10kV do të furnizohen nga furnizuesi me shërbim universal për një fazë tranzitore deri më 31 mars 2018. Ndërsa Konsumatorët e kyçur në nivelin e tensionit 0.4kV të cilët nuk i plotësojnë kriteret e përcaktuara me ligj për furnizim me energji elektrike nga Shërbimi Universal, do t'i nënshtrohen kushteve dhe çmimeve të tregut për furnizim me energji elektrike pas përpilimit të listës nga ana e Rregullatorit.
 7. Rregullatorit me qëllim të nxitjes së konkurrencës, do të shtyj në treg në mënyrë graduale të gjithë konsumatorët të cilët nuk i plotësojnë kriteret e përcaktuara për furnizim me shërbim universal sipas Ligjit për Energji Elektrike.
- X.** Vendimi nxirret në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës.
- XI.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Bordi i Rregullatorit:



Krenar Bujupi, u.d. kryesues



Arsim Janova, anëtar



Besim Sejfiqaj, anëtar

Vendimi i dërgohet:
KESCO-s
Aktivit të Rregullatorit